



Datë: 27.08.2025
Numër Protokolli: 5790/2025

A.nr.755/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bektashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.755/2025, të datës 30.04.2025, të parashtruar nga ankuesi A.RR, kundër organit të punësimit: Komuna e Leposaviqit, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me Nenin 16, paragrafin 3, dhe Nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si bazuar ankesa me A.nr.755/2025, e datës 29.04.2025, e parashtruar nga ankuesi A.Rr.

II. Anulohet në tërësi procedura e pranimi më numër reference RN00016530, pozita Zyrtar për Regjistrim të Bizneseve, në Departamentin për Investime dhe Zhvillim Ekonomik pranë Komunës së Leposaviqit.

III. Obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Leposaviqit, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të ndërmarr të gjithë veprimet e nevojshme administrative më qëllim të zbatimit të këtij vendimi sikurse është përcaktuar në pikën II të dispozitivit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil A.Rr (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 29.04.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference, RN00016530, për pozitën “Zyrtar për Regjistrimin e Bizneseve”, të shpallur nga Komuna e Leposaviqit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 08.05.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Leposaviqit, ndërsa, kjo e fundit, më datë 20.05.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat materiale referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2812/2025, të datës 29.04.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimet e datës 01.04.2025; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Formularin e parashtrimit të ankesës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 08.05.2025; Përgjigjen në ankesë së bashku me dokumentet e dorëzuara nga organi i punësimit të datës 20.05.2025; Njoftimin me Nr.32/2025 të datës 06.03.2025; Vendimin Nr.1994 të datës 07.03.2025 së bashku me akt emërimet e anëtarëve të Komisionit të pranimit; Kërkesën për fillimin e procedurës së rekrutimit të datës 29.01.2025; Njoftimin për testin me shkrim të datës 13.03.2025; Testin me shkrim të ankuesit A.Rr; Testin me shkrim të kandidatës fituese N.J; Testin me shkrim të kandidatës fituese L.M; Njoftimin për intervistë me gojë të datës 07.04.2025; Formularët e vlerësimit individual të intervistës me gojë nga Komisionin i Pranimit të datës 08.04.2025; Njoftimin për rezultatin përfundimtar të vlerësimit me numër Nr.87/2025 të datës 22.04.2025; Aplikacionin me datë aplikimi 30.01.2025 të kandidatit A.R; Aplikacionin me datë aplikimi 28.02.2025 të kandidatës N.J; Aplikacionin me datë aplikimi 14.02.2025 të kandidatës L.M; Vendimin me numër protokolli 4013/2025 të datës 13.06.2025 të Kryetarit të Këshillit; Kërkesën e datës 30.06.2025 drejtuar Komunës së Leposaviqit; Përgjigjen në kërkesë të datës 30.06.2025.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e bazuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Komuna e Leposaviqit më datë 29.01.2025, ka shpallur Konkursin publik me numër reference RN00016530, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, për pozitën Zyrtar për Regjistrim Civil, në Departamentin për Investime dhe Zhvillim Ekonomik, më klasë të pozitës profesional 3, dy (2) vende të lira pune, i hapur për aplikim nga data 30.01.2025 deri më datë 28.02.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë procedurë të pranimit ka aplikuar edhe ankuesi i cili ishte përfshirë si kandidat që plotëson kriteret për pozitën e shpallur, gjegjësisht ankuesi i është nënshtruar fazës së vlerësimit përmes testit me shkrim duke arritur gjithsej 51.6 pikë, ndërsa në intervistën me gojë ankuesi është vlerësuar më 17.56 pikë, total ankuesi ka arrit 69.16 pikë, si pikë të pamjaftueshëm për tu konsideruar si kandidat i suksesshëm.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Leposaviqit, më datë 22.04.2025, ka publikuar Njoftimin me numër Nr.87/2025, nga i cili njoftim rezulton se si kandidatë të suksesshme për pozitën përkatëse të rekrutimit janë shpallur N.J me 88.68 pikë dhe L.M me 87.14 pikë.

Ankuesi më ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se konkursi RNOOO16530 është përcjell më parregullsi. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar në atë mënyrë që të sigurohet transparenca në këtë proces rekrutimi.

Kolegji i Këshillit mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”, ka analizuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet administrative të ndërmarra në procedurën e rekrutimit me numër reference

RN00016530. Rrjedhimisht, në kontekst të këtij përcaktimi, e në kuptim të kriterëve formale të përgjithshme Kolegji ka analizuar aktin e shpalljes së konkursit me numër reference RN00016530 dhe si pasojë ka konstatuar së pozita Zyrtar për Regjistrimin e Bizneseve është shpallur në Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, klasa Profesional 3, ndërsa, si kriterë të përgjithshme formale janë vendosur: Arsimimi i kërkuar: Diplomë e shkollës së mesme apo ekuivalente me të; Përvoja e punës e kërkuar: Nuk kërkohej.

Rrjedhimisht, Kolegji konstaton së organi i punësimit me rastin e shpalljes së konkursit përkatës ka vepruar në kundërshtim me Katalogun e vendeve të punës në shërbim civil, sepse, pozita Zyrtar për regjistrim të bizneseve është e kategorizuar me Kodin: SHC-1402; klasa: Profesional 2; emri i grupit: Administrim i përgjithshëm; fusha e arsimit: Arsim i lartë i paspecifikuar, ndërsa, Komuna e Lepasaviqit me rastin e shpalljes së konkursit të kontestuar pozitën zyrtar për regjistrim të bizneseve e ka kategorizuar në Klasën Profesional 3, klasë në të cilën përfshihen pozita për të cilat kërkohen detyra administrative dhe mbështetëse për zyrtarë tjerë profesional.

Rrjedhimisht referuar pikës 1 të Konkursit NRN0001653, si detyra të punës për pozitën Zyrtar për regjistrimin bizneseve janë vendosur: Bënë regjistrimin dhe çregjistrimin e të gjitha llojeve të bizneseve; Ofron këshilla rreth regjistrimit apo çregjistrimit të bizneseve; Kryejnë rregullimin e dokumentacionit për ndryshime eventuale në biznese si dhe për dhënien e certifikatave të reja të biznesit; Raportojnë për punën e tyre në Ministrinë për Tregti dhe Industri; Merr pjesë në ekipet punuese për hartimin e strategjive zhvillimore; Prezanton treguesit e zhvillimit krahasuar me periudha të ndryshme kohore; Definon shkaqet e mosrealizimit të planeve zhvillimore; Ofron këshilla profesionale për biznese;... e që në vlerësimin e Kolegjit këto detyra nuk janë të natyrës administrative dhe mbështetëse, por detyra që kërkojnë njohuri të përgjithshme profesionale në fusha të caktuara. andaj, duke u bazuar në konstatimet si më sipër e në kuptim të nenit 19 dhe nenit 31 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ku përcaktohet se: “19. Kërkesat e përgjithshme formale, përfshijnë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës që janë të domosdoshme për kryerjen me sukses të detyrave dhe përgjegjësi; 30.1. Me qëllim të lehtësimit të procesit të klasifikimit dhe grupimit të vendeve të punës për kategorinë profesionale, hartohet katalogu i vendeve të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe miratohet nga Qeveria, me propozim të Ministrisë Përgjegjëse për Administratë Publike. 30.2. Katalogu i vendeve të punës përmban emërtimin e pozitës, kategorinë, klasën, grupin dhe kriteret e përgjithshme si dhe përshkrimin e vendit të punës për çdo pozitë.”, konstatoi se Komuna e Lepasaviqit me rastin e shpalljes së konkursit për pozitën Zyrtar për regjistrimin e bizneseve ka vepruar në pajtueshmëri me Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbim Civil, dhe së një veprimi i tillë ka qenë diskriminues në njërin anë dhe favorizues në anën tjetër, sepse, ka favorizuar kandidatet që kanë shkollim të mesëm, ndërsa ka diskriminuar kandidatet me shkollim të lartë arsimor, ashtu q të njëjtë i është e pamundësuar edhe e drejta në aplikim.

Andaj, bazuar në rrethanat dhe konstatimet e dhëna si më sipër, Kolegji vlerëson së vendosja e kriterëve të konkursit në kundërshtim me kriteret e përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi, ka bërë që procedurat e kontestuar të kualifikohen si veprime të paligjshme administrative në kuptim të nenit 52, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Rrjedhimisht, duke qenë së akti e shpalljes së konkursit kontestuese është përfshirë me shkelje esenciale materiale, atëherë, çdo veprim tjetër procedural i ndërmarrë në këtë procedura është juridikisht i pavlefshëm dhe nuk prodhon efekte juridike.

Thëne si më lartë, Kolegji në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e me qëllim të kthimit të ligjshmërisë, vendosi për aprovimin e ankesës si të bazuar, duke anuluar në tërësi procedurën e pranimit më numër reference RN00016530, pozita Zyrtar për Regjistrim të Bizneseve, në Departamentin për Investime dhe Zhvillim Ekonomik pranë Komunës së Leposaviqit.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.755/2025

Avdyl Bekteshi

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, A.Rr;
- Organit të punësimit: Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Leposaviqit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.